

1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

---

Në mbështetje të neneve 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/10 qershor 2016), si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastet Nr. KO216/22 dhe KO220/22, Auditori i Përgjithshëm miraton:

**RREGULLORE (ZKA) NR. 02/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E RREGULLORES (ZKA) NR. 02/2024 PËR  
ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE  
TË PUNËS**

---

<sup>1</sup> Rregullore ZKA Nr. 02/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKA) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, e nënshkruar nga Auditorja e Përgjithshme me datë: 27.11.2025, me Vendim Nr.2187 /2025.

## **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKA) Nr. 02/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

## **Neni 2**

Neni 11, paragrafi 4 i Rregullores bazike fshihet.

## **Neni 3**

Neni 12, paragrafi 4 i Rregullores bazike fshihet.

## **Neni 4**

Neni 13, paragrafi 4 i Rregullores bazike fshihet.

## **Neni 5**

Neni 16, pas paragrafit 1.11 shtohet paragraf i ri 1.12 si vijon:

1.12. Shërben si pikë e kontaktit dhe kujdeset për raportimin e progresit në kuadër të procesit të integrimi evropiane.

## **Neni 6**

Neni 19, titulli i nenit ndryshohet si vijon: "Njësia për Çështje Juridike".

## **Neni 7**

Neni 20, paragrafit 1.2 i Rregullores bazike fshihet.

## **Neni 8**

Neni 21, paragrafi 1.6 i Rregullores bazike ndryshohet si vijon:

1.6. DMBNJ e njofton Departamentin për Buxhet, Financa dhe Raportim për të gjitha ndryshimet në listën e pagave në baza mujore.

## **Neni 9**

Neni 23, pas paragrafit 1.6 shtohet paragraf i ri 1.7 si vijon:

1.7. Përgatitja e të gjitha ndryshimeve në paga dhe procesimi i tyre në sistemin e pagesave (Payroll) në baza mujore.

### **Neni 10**

Neni 31, paragrafi 2 i Rregullores bazike ndryshohet si vijon:

2. Për zbatimin e Planit Vjetor të Auditimi, ekipi i auditimit udhëhiqet nga Auditori Specialist i cili emërohet me vendim të Auditorit të Përgjithshëm. Auditori i Përgjithshëm ka të drejtën të caktojë edhe nivele tjera të auditorëve në përputhje me nevojat dhe rrethanat specifike.

### **Neni 11**

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Aktet e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me përshkrimin e detyrave të punës për të punësuarit e ZKA-së, mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve tjera.

2. Në pajtim me këtë Rregullore, të punësuarve në ZKA iu zëvendësohen aktet individuale të marrëdhënies së punës, jo më larg se nëntëdhjetë (90) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

### **Neni 12**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Vlora SPANCA**

---

**Auditore e Përgjithshme**